# ZYRË PËRMBARIMORE PRIVATE
# 3L

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Nr. 32387 Prot.
Datë 23.11.2022

Nr 1648 prot                                                                                   Durrës më 21.11.2022

**URDHËR**

**PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE**

**Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT**

**TIRANË**

Në Durrës sot më datë 21.11.2022.

Unë **HARILLA A. ÇIPI** Përmbarues Gjyqësor Privat me çertifikatë nr. 244 pranë **Zyrës së Përmbarimit Private "3L" shpk** pasi studiova dosjen përmbarimore si dhe në zbatim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. (11-2022-5162) 1410 datë 26.10.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**KONSTATOVA**

Se në datën 07.11.2022 Kreditori **Shoqëria "German Albanian Logistics Agency" shpk** ka paraqitur pranë **Zyrës së Përmbarimit Private "3L" shpk** kërkesën për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv Faturat Tatimore se bashku me Urdhërit të Ekzekutimit Nr. (11-2022-5162) 1410 datë 26.10.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me palë:

- **Kreditor : Shoqëria "German Albanian Logistics Agency" shpk**
- **Debitor : Shoqëria "VENTUS"shpk me NIPT: L82212033T**
- **Me objekt : Kthim Shume**

Pasi janë zbatuar proçedurat ligjore të njoftimit drejtuar palës debitore për ekzekutim vullnetar të detyrimit, pala debitore nuk ka kryer ekzekutimin vullnetarisht të detyrimit që përmban Titulli Ekzekutiv.

Me vendimin e Përmbaruesit Gjyqësor Privat ekzekutimi i Titullit Ekzekutiv ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Në këto kushte kur për ekzekutimin e Urdhër Ekzekutimit duhet të kryhet bllokimi i aksioneve që zotëron debitori **Shoqëria "VENTUS" shpk me NIPT: L82212033T me administrator Z. Elman Abule** me qëllim mostjetërsimin e tyre për tu shmangur nga detyrimi.

# ZYRË PËRMBARIMORE PRIVATE
# 3L

*Mbështetur në  nenet 519 ,527, 593  të Kodit të Proçedures Civile në nenit 36/3, dhe 53 i Ligjit 26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat" .*

**URDHËROJMË**

1. Vënien e masës së sekuestros konservative mbi aksionet e debitorit **Shoqëria "VENTUS" shpk me NIPT: L82212033T me administrator Z. Elman Abule** me qëllim mostjetërsimin e tyre për tu shmangur nga detyrimi për ekzekutimin e Urdhërit Ekzekutimit.
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Personat që bëhen pengesë do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të Kodit të Proçedurës Civile.
4. Ky urdhër mbahet në disa kopje dhe u  njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brënda 5 ditëve.

**ZYRË PËRMBARIMORE PRIVATE**
**"3L" SHPK**
**ADMINISTRATOR**

**HARILLA A. CIPI**

Zyrë Përmbarimore Private "3L" sh.p.k , NUIS : L02401505K
Adresa : Lgj nr.3 , Sheshi "Liria" , Qëndra Biznesit Best Co. Kati i 7-të , pranë Bashkisë Durrës.
00355676452525 ; zyrepermbarimore3l@gmail.com